



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 14 tetor 2020, në mjediset e AMA-s, u zhvillua mbledhja e radhës e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. “Miratimin e Strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe Planit të Veprimit, për periudhën 2021-2023”. (**Vendimi nr. 94, datë 14.10.2020**)
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 61, datë 21.08.2020 të AMA-s “Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor “ABC NEWS”; Rinovimin e licencës së shoqërisë “ABC NEWS” sh.a., për subjektin audio privat vendor “ABC NEWS” dhe reduktimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit në “*Bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Durrës dhe Shijak*”. (**Vendimi nr. 95, datë 14.10.2020**)
3. Shfuqizimin e vendimit nr. 60, datë 21.08.2020 të AMA-s “Për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k., për marrje licence transmetimi audio private lokale për subjektin audio “Saranda Ime Radio”; Dhënien e licencës private lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “Radio Televizioni Saranda” sh.p.k. për subjektin audio “Saranda Ime Radio” për të mbuluar me sinjal audio, “*Bashkinë Sarandë*” (**Vendimi nr. 96, datë 14.10.2020**)
4. Dhënien e të drejtës së përdorimit të frekuencave 90.5 MHZ dhe 91.5 MHZ, 89.5, Radiotelevizionit Shqiptar (RTSH mbi mbulimin me sinjal audio të zonës së shërbimit të bashkive Himarë (për Radio Tirana 1) dhe Pogradec (për Radio Korça). (**Vendimi nr. 97, datë 14.10.2020**)
5. Miratimin e shtojcës së Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, për çeljen e shërbimit audio të transmetuesit publik “Radio Tirana Fëmijë”. (**Vendimi nr. 98, datë 14.10.2020**)
6. Miratimin e shtojcës së kontratës së shërbimit të transmetimit publik, për çeljen e shërbimit audioviziv të transmetuesit publik, “RTSH Kukësi”. (**Vendimi nr. 99, datë 14.10.2020**)
7. Miratimin e shtojcës së kontratës së shërbimit të transmetimit publik, për ndryshimin e emrit të shërbimit programor nga “RTSH Fëmijë 2” në “RTSH Shkollë”. (**Vendimi nr. 100, datë 14.10.2020**)

Gjatë zhvillimit të mbledhjes, 3 anëtarë të AMA-s e ndërprejnë mbledhjen dhe çështjet e tjera të rendit të ditës,

- Relacion dhe projektvendim “Për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Channel One” sh.p.k., për subjektin audioviziv privat “TV Ora News”,
- Relacion dhe projektvendim “Mbi shqyrtimin e aplikimit së Radio Televizionit Shqiptar, për rinovimin e licencës për ritransmetimin e programit audio me përsëritës “Radio BBC”,

Page | 2

për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor për vijimin e mbledhjes së AMA-s (4 anëtarë), shtyhen për në mbledhjen e radhës.

## **AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

**Tiranë, më 14 tetor 2020**